

SEIT MANSAKU***LESIKU I VEPRËS SË PJETËR BOGDANIT NGA ANILA OMARI,
QSA, TIRANË, 2016***

Vepra “Fjalori i Cuneus prophetarum” të Pjetër Bogdanit, hartuar nga prof. Anila Omari, është frut i një pune shumëvjeçare të autores dhe i përvojës së saj të gjatë në fushën e filologjisë së teksteve të vjetra, sidomos të veprës së Pjetër Bogdanit. Ajo ka përgatitur e botuar prej disa vitesh transkriptimin e plotë të kësaj vepre me një studim të gjatë hyrës për historinë dhe vlerat e shumta të veprës, për kriteret e transkriptimit të saj, për veçoritë themelore, sidomos fonetike të tekstit. Besoj se të gjithë jemi të një mendimi se botimi kritik i disa viteve më parë është pritur mirë nga kritika shkencore dhe nga opinioni shkencor intelektual i qarqeve shkencore albanologjike brenda dhe përtej gjuhësisë sonë. Ajo, pas botimit kritik të Mesharit të Gjon Buzukut, është pa dyshim vepra themelore filologjike për tekstet e vjetra. Botimi i saj ka luajtur dhe po luan një rol nxitës ndikues tek studiues të tjerë dhe te studentët e fakulteteve filologjike për të njohur më mirë veprën e Pjetër Bogdanit dhe për të ndërmarrë studime të veçanta si tema disertacionesh për master e doktoratura.

Duke pasur parasysh përgatitjen solide gjuhësore e filologjike dhe përvojën e gjatë të autores në fushën e studimeve filologjike dhe gjuhësore, nuk është e papritur që sot kemi përpara një tjetër vepër nga kjo fushë, një vepër serioze, e hartuar me kriteret e mirëfillta shkencore, që është pa dyshim një kontribut i mëtjshëm i saj në fushën e studimeve gjuhësore e filologjike për shqipen, rezultat i njohjes së mirë të teorive dhe praktikave tradicionale dhe të reja, e realizuar me metoda e teknika moderne.

Vepra që po paraqesim sot, është vijim i mëtjshëm i punës së autores në fushën e studimit të teksteve të vjetra, por është sigurisht një vepër e re, origjinale me shumë kontribute dhe dobi për historinë e gjuhës, për leksikografinë historike, për etimologjinë dhe tekstologjinë. Niveli shkencor i veprës dëshmon se është punuar me pasion, me njohje të mirë të lëndës që bëhet objekt studimi dhe i bazave teorike mbi të cilat është realizuar. Jam i bindur se *Fjalori i veprës së Bogdanit* do të pritet me interes nga rrethet shkencore e kulturore albanologjike dhe do të ndihmojë për zhvillimin e mëtjshëm të studimeve të kësaj natyre.

Vepra përbëhet nga dy pjesë, studimi hyrës dhe fjalori.

Në studimin hyrës të botimit kritik të veprës së Bogdanit të realizuar e botuar para disa vitesh, siç dihet tashmë, janë trajtuar mjaft gjerë jeta dhe

personaliteti i Pjetër Bogdanit, përmbajtja e veprës, historia e hartimit dhe e botimit të saj, grafia, paraqitja dhe shpjegimi i shenjave grafike, kriteret e transkriptimit të saj, identifikimi i tingujve zanorë e bashkëtingëllorë, etj. Studimi hyrës i këtij vëllimi trajton përmasat, përbërjen dhe veçoritë e leksikut të veprës së Bogdanit, shtresëzimin historik të tij, fushat semantike të tij etj.

Siç e ka vënë në dukje vetë autorja, botimi leksikut të plotë të një autori të teksteve të vjetra shqipe si Pjetër Bogdani me një vepër të gjerë e me tematikë të larmishme si Çeta e profetëve (1685), është pa dyshim një ndërmarrje e vështirë dhe e rëndësishme si për të njohur, kuptuar dhe vlerësuar siç e meriton, veprën dhe autorin e saj, ashtu edhe për të hedhur një hap të madh përpara për përgatitjen e një Fjalori të autorëve të vjetër dhe më gjerë për hartimin e një fjalori historik të gjuhës shqipe. Është me vlerë si për leksikologjinë historike, ashtu edhe për leksikografinë e sotme.

Autorja e nis hyrjen studimore me sqarimin shkurt të qëllimit dhe të metodës së një botimi kritik të ndërtuar sipas kriterëve të filologjisë tekstuale dhe me metoda të nxjerrjes së konkordancave elektronike kontekstuale. Metoda e analizës së konkordancës i ka dhënë mundësi autores të shqyrtojë përdorimin kontekstual të fjalëve dhe të analizojë kuptimet e tyre në kontekstet përkatëse dhe në përgjithësi. Me të drejtë janë vënë në dukje përparësitë e metodës së konkordancës dhe aplikimet e saj në disa vepra të viteve të fundit nga autorë të ndryshëm.

Zgjedhja që ka bërë autorja për të hartuar e botuar një fjalor të plotë shpjegues të veprës së Pjetër Bogdanit në vend të botimit të një konkordance të plotë e shumë të vëllimshme të tekstit tërësor të veprës së P. Bogdanit është e arsyetuar, e motivuar mirë prej saj. Fjalori që përmban të gjitha lemat e tekstit, të shoqëruara me një konkordancë të thjeshtuar për secilën fjalëformë, të vendosura në një kontekst të reduktuar, por të mjaftueshëm për të sqaruar strukturën semantike të fjalëformës është e drejtë dhe me dobi praktike për përdorimin e Fjalorit për qëllime të ndryshme. Po kështu e përligjur është edhe dhënia e kuptimeve të fjalës që dalin nga teksti në gjuhën italiane. I ndërtuar në këtë mënyrë Fjalori, kuptimi leksikor i lemave del e sqarohet nga konteksti i tekstit shqip edhe i versionit italisht. Përveç këtyre, edhe njohja e gjuhës së sotme shqipe dhe në veçanti e dialektit në cilin ka shkruar Bogdani, kanë rëndësi për saktësimin e kuptimit të leksikut të veprës së Bogdanit.

Një syth të veçantë autorja i ka kushtuar *Koinesë mbidialektore të Bogdanit*. Është një çështje e rëndësishme për historinë e gjuhës letrare shqipe, për historinë e gjuhës së shkruar, një problem i diskutuar nga shumë studiues në studime të tyre. Vepra e Pjetër Bogdanit, gjuha e saj, pohimet që bën vetë Bogdani në Parathënie japin shkas për ta trajtuar këtë çështje. Është i drejtë vlerësimi i kontributit të veçantë të Bogdanit në krijimin e një koineje më të gjerë përtej të folmeve verilindore të cilave u përkiste Bogdani.

Sythy i dytë i studimit hyrës trajton *Shtresëzimet leksikore në tekstin e Cuneus Prophetarum*. Në këtë syth është bërë një analizë e thelluar disaplanëshe e leksikut të veprës së Bogdanit, një analizë fjalëformuese, burimore me shumë interes në disa vështrime. Gjatë kësaj analize janë nxjerrë në pah veçoritë e leksikut të veprës së Pjetër Bogdanit, kontributi i autorit në lëvrimin dhe pasurimin e shqipes me fjalë e kategori të reja leksikore, struktura fjalëformuese e leksikut të tij, etj. Një interes të veçantë paraqet leksiku abstrakt dhe shtjellimi i rrugëve dhe i mjeteve të formimit të tij, me prapashtesa, nga emrat asnjans prejmbiemërorë, krijimi i emrave foljorë nga foljet përkatëse, emrat mashkullorë të veprimit me prapashtesën *-im*, emrat femërorë me prapashtesim që shprehin rezultat veprimi, emrat femërorë prejfoljorë me prapashtesën *-ë* të tipit *dokë, dekë, trembë* etj., emra të formuar prej foljeve me prapashtesat *-me* dhe *-e* që tregojnë rezultat veprimi: *dëneshme dredhe, e dridhme* etj., kompozita e fjalë të përngjitura. Në këtë syth ka formime me shumë interes si për historinë e gjuhës dhe etimologjinë ashtu edhe për lëvrimin dhe zhvillimin e gjuhës së shkruar letrare shqipe. Autorja ka bërë një punë shumë të kujdesshme për të dhënë kuptimet e fjalëve dhe për të përcaktuar a rindërtuar trajtën përfaqësuese kur ajo nuk gjendet në tekst.

Një syth i veçantë i është kushtuar në studimin hyrës përdorimit të mbiemrave të cilin autorja e konsideron si një tipar të rëndësishëm që dallon një gjuhë të përpunuar letrare. Siç ka vënë në dukje autorja, Bogdani për të formuar mbiemra me kuptime e nuanca të ndryshme ka përdorur mjete fjalëformuese të shqipes, parashtesa e prapashtesa por edhe kalke sipas modeleve të italishtes. Një vend të veçantë zënë mbiemrat me parashtesat *për-* dhe *pa-*, formimet me prapashtesën *-shim*. Autorja me të drejtë vë në dukje se në këtë fazë të vjetër të shqipes ishte ende i paqartë dallimi semantik i mbiemrave prejpjesorë të formuar thjesht me nyjëzim, sot me kuptim kryesisht pjesor, nga mbiemrat prejfoljorë me prapashtesën *-shim*, sot *-shëm*, me kuptim kryesisht vepror ose mundësor. Një dallim i tillë nuk është aq i prerë edhe sot në dialektin e Jugut dhe në gjuhën standarde. Më tej autorja trajton mbiemrat dhe emrat e vepruesit me prapashtesat *-or*, *-(ë)tor*, *-sor*, *-ar*, *-tar*. Janë bërë përpjekje për të dalluar dhe vënë dukje krijimet e Bogdanit, neologjizmat e tij, formalë dhe kuptimorë, si edhe kalket.

Rigjallërimi i leksikut popullor paraqitet nga autorja si një nga rrugët që përdor Bogdani për pasurimin leksikor të gjuhës letrare. Në punim jepet një listë fjalësh që përdor Bogdani dhe që në shqipen e sotme janë të vjetruara, ose kanë dalë jashtë përdorimit. Këto ka të ngjarë të jenë fjalë të gjuhës së folur që janë përdorur nga Bogdani dhe janë ngritur në nivelin e gjuhës së shkruar në veprën e tij. Për burimin e tyre autorja ka shfrytëzuar Fjalorin etimologjik të G. Meyer-it dhe Studimet etimologjike në fushë të shqipes të E. Çabejt. Janë trajtuar me hollësi e me njohje të mirë huazimet diturore nga italishtja, duke dhënë edhe shifra, dhe huazimet popullore nga turqishtja, nga sllavishtja dhe

nga italishtja popullore. Janë me interes edhe shtresëzimet sipas fushave semantike-kronologjike të huazimeve sllave të Bogdani, duke dalluar ato që janë te të gjithë autorët nga ato që janë vetëm të Bogdani. Sipas fushave semantike janë trajtuar edhe turqizmat.

Do të kisha dashur që autorja të bënte një klasifikim të fjalorit sipas fushave semantike, p.sh. leksik i fushës fetare, historike, filozofike, astronomike etj. për të vënë në dukje larminë tematike të veprës së Bogdanit. Është një detyrë që autorja mund ta bëjë në një studim të ardhshëm.

Si njohëse e veprave të autorëve të vjetër në përgjithësi dhe e studimeve për to, ajo ka qenë në gjendje të bëjë krahasime herë pas here për përdorimet dhe kuptimet e fjalëve të ndryshme në këto vepra, duke vënë në dukje atë që kanë të përbashkët nga ajo që i dallon ato. Kjo është një vlerë e shtuar e këtij punimi. Pas këtij parashtrimi mjaft të plotë të tipareve të leksikut të veprës së Pjetër Bogdanit, autorja parashtron *kriteret e ndërtimit të Fjalorit*.

Mua më duket se kriteret e ndërtimit të Fjalorit qëndrojnë mirë. Janë ndërtuar e shpjeguar qartë; duket se janë gjetur zgjidhjet më të mundshme e më të përshtatshme. Rruga që ndiqet për rindërtimin e trajtës përfaqësuese më duket e drejtë, megjithëse herë-herë mund të jetë e vështirë dhe jo krejt e sigurt. Megjithatë mua më duket se autorja ka arritur t'i kapërcejë vështirësitë. Mënyra e dhënies dhe e renditjes së kuptimeve më duket e drejtë dhe e menduar mirë. Përfshirja e trajtave joveprore të foljeve në një lemë me trajtat veprorë më duket zgjidhje e përshtatshme. Po kështu edhe nxjerrja si lema më vete e homonimeve, megjithëse nuk është gjithmonë i qartë dallimi midis një kuptimi të larguar nga kuptimi bazë dhe daljes si fjalë homonime më vete. Në rastin e veprës së Bogdanit ndihmon shumë versioni në italishte.

Një problem të vështirë përbën rindërtimi i formave bazë kur ajo nuk del në tekst. P.sh. f. 50 **me adhoruem* khs. *adhëruem*, **bdekun* dhe *dekun*, *qengj* dhe *kingj*. Duhet sqaruar më mirë kriteri që përdoret. Me të drejtë trajtohet me rezervë rindërtimi si asnjansës i emrave të tipit *mjaltë*, *brume*, *drithë* etj. Trajta **arbënuer* nuk mund të them se qëndron se, me sa di unë, Bogdani ka shumësin *arbënorët*. Në rindërtimet duhet të merret parasysh edhe përdorimi i sotëm dialektor duke u mbështetur në punimet dialektore. Kjo duhet të thuhet edhe në kriteret.

Autorja në një syth të veçantë ka sqaruar edhe çështjen e *shënimeve gramatikore*.

Mjaft i ndërlikuar paraqitet edhe përcaktimi i gjinisë në numrin shumësin e emrave asnjansës të tipit të *qeshurat* të khs. të *qeshurit*, e *qeshura* etj. Autorja ka bërë një analizë të thelluar të gjendjes së kësaj kategorie emrash të Bogdani dhe të autorëve të tjerë të vjetër. Në analizën kuptimore ajo mbështetet shumë te teksti në italisht. Për një gjykim sa më afër së vërtetës në këto raste janë me rëndësi edhe të dhënat dialektore. Autorja e këtij punimi, duket fare qartë nga shtjellimi, se i ka ndjekur me shumë vëmendje si trajtat ashtu edhe kuptimet e

kësaj kategorie emrash, duke dhënë edhe statistika për frekuencën e përdorimit të tyre. Ajo si përfundim ka ndërtuar dy lema të ndryshme për këto kategori emrash, një të gjinisë asnjane të *mirëtë* dhe një të gjinisë femërore *e mira* dhe dy trajta përkatëse të shumësit, që, sipas autores, kanë përgjithësisht kuptime të njëjta. Kjo ndodh pothuajse gjithmonë kur një kategori e caktuar trajtash priret të zëvendësohet në mënyrë graduale nga një tjetër dhe për një fare kohe bashkëjetojnë të dyja.

Një vëmendje të veçantë u ka kushtuar autorja të ashtuquajturve *mbiemra reliktorë*. Kjo kategori mbiemrash është analizuar hollësisht nga autorja si nga ana e formës ashtu edhe nga ana semantike dhe e funksioneve sintaksore që kryejnë në periudhë, sepse, siç ka vënë re me të drejtë ajo, kriteri morfologjik është i pamjaftueshëm. Gjithashtu është pasur parasysh si aspekti sinkronik i tyre ashtu edhe ai diakronik. Autorja merret gjatë me funksionin e përcaktorit kallëzuesor, sepse përdorimi i këtyre mbiemrave reliktorë është i lidhur me këtë funksion. Raporti mbiemër-ndajfolje i ka dalë autores si problem për kategorizimin e një grupi fjalësh që qëndrojnë në mes të këtyre dy kategorive leksikogramatikore. Autorja është pajtuar me mendimin se leksemat pa nyje në funksione predikative trajtohen si mbiemra dhe jo si ndajfolje dhe kështu shënohen në Fjalor. Me interes është paraqitja e gjendjes së kësaj dukurie te autorët e vjetër. Janë me interes të veçantë shembujt e zgjedhur për ilustrimin e kësaj dukurie.

Studimi hyrës përfundon me disa sqarime e mendime rreth disa leksemave a trajtave gramatikore që kanë në përbërjen e tyre trajtën foljore *do* të foljes *dua*. Unë pajtohem me interpretimet që bën autorja lidhur me rastet e Bogdanit. Dyshoj për rastin e Buzukut për të vetmin shembull *do ta pi kelqin*. Edhe unë kam shprehur mendimin se rasti i vetëm Buzukut nuk provon ekzistencën e të ardhmes me *do* në gegërishten e shekullit XVI, por nuk e kam vënë në dyshim interpretimin e tij si e ardhme, duke u nisur nga teksti latin dhe nga fakti se kjo fjali në të njëjtin kontekst gjendet edhe me të ardhmen me *kam* : *kam me pitë*.

Duke përfunduar, nuk dua të përsëris edhe një herë vlerësimet që bëra në fillim të këtij recensionit, por po ritheksoj se kemi përpara një punim shumë serioz që shënon pa dyshim një kontribut të veçantë në studimet filologjike shqiptare. E përgëzoj autoren dhe i uroj suksese të tjera në këtë fushë studimesh.

